



Nr. 02/2012

## **Vërtetimet Tatimore tani merren në zyrën më të afërt të ATK-së dhe mund të përdoren më shumë se një herë**

Me qëllim të lehtësimit të procedurave dhe ofrimit të shërbimeve më profesionale, transparente dhe më efektive për tatimpaguesit dhe për të gjithë të punësuarit (qoftë si shërbyes civil apo të punësuar në ndonjë biznes privat), Administrata Tatimore e Kosovës, njofton se **Vërtetimet Tatimore**, të cilat lëshohen për të paraqitur gjendjen tatimore të tyre, mund të merren në zyrën më të afërt regjionale të ATK-së.

Vërtetimi Tatimor, si: Vërtetimi për Vizë, Nënshetësi, Lehoni, etj. mund të merret në Zyrën Regjionale më të afërt të Administratës Tatimore të Kosovës, pavarësisht se cilit regjion i përket tatimpaguesi apo i punësuar, ndërsa Vërtetimi për Tender dhe Vërtetimi për Çregjistrim të biznesit, vazhdon të merret vetëm në Zyrën Regjionale të cilës i përket tatimpaguesi.

Gjithashtu, si rrjedhojë e procesit të përmirësimit të shërbimeve për tatimpagues, nga Shkurti i vitit 2012 ATK ka zgjatur afatin e vlefshmërisë së Vërtetimeve Tatimore me ç'rast tatimpaguesit mund shfrytëzojnë të njëjtin vërtetim më shumë se një herë.

Afatet e vlefshmërisë, janë zgjatur si në vijim:

1. Vërtetimi për **Tender** – i vlefshëm **90 ditë** nga data e lëshimit;
2. Vërtetimi për **Vizë** – i vlefshëm **6 muaj** nga data e lëshimit;
3. Vërtetimi për **Çregjistrim të biznesit** – i vlefshëm **10 ditë** nga data e lëshimit;
4. Vërtetimi për **Prishje të nënshetësisë** – i vlefshëm **90 ditë** nga data e lëshimit
5. Vërtetimi për **“Të tjera”** – i vlefshëm **90 ditë** nga data e lëshimit